

Hapet thirrja për aplikime për bursa në Universitetin Çukurova në Turqi, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA 107.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për mësimdhënie në Universitetin Çukurova në Turqi, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA107 për semestrin e dytë të vitit akademik 2018 - 2019.

Llojet e mobilitetit:

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Fushat e shkëmbimit:

- Kimi
- Matematikë dhe Statistikë;
- Shkencat e Natyrës;
- Bioteknologji;
- Administrim Biznesi;
- Ekonomiks;
- Financë;
- Mësimdhënie e Gjuhës Angleze;

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

Për më shumë informacion mbi Universitetin e Cukurovës ju lutemi referohuni linkut:

<https://www.cu.edu.tr/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin për stafin (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV (në gjuhën angleze) + Lista e publikimeve;
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze niveli B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë ose jo mobilitet Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Afati për aplikim: 15 shkurt 2019

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara të dërgohen në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!